

# UDHËZUES

## “PËR LIKUIDITETIN DHE FINANCIMIN NË NDËRHYRJE TË JASHTËZAKONSHME”<sup>1</sup>

Banka e Shqipërisë  
2023

---

<sup>1</sup> Për pyetje dhe komente në lidhje me këtë udhëzues, kontaktoni në adresën [resolution@bankofalbania.org](mailto:resolution@bankofalbania.org)

## PËRMBAJTJA

1. Qëllimi dhe objektivat.....	3
2. Zbatimi dhe faza përgatitore .....	3
3. Udhëzuesi operacional .....	4
3.1. Identifikimi i njësive kryesore të likuiditetit (NjKL).....	4
3.2. Identifikimi i faktorëve kryesorë që nxisin nevojën për likuiditet gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme .....	6
3.3. Sjellja e kundërpalës gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme .....	9
3.4. Detyrimet financiare që lidhen me aksesin në Infrastrukturën e Tregjeve Financiare kritike .....	9
3.5. Nevojat ditore ( <i>intraday</i> ) për likuiditet.....	10
3.6. Detyrimet financiare të lidhura me vazhdimësinë operacionale .....	10
3.7. Ndikimi i veprimeve të agjencive të vlerësimit ( <i>rating agencies</i> ).....	10
3.8. Vlera e likuiditetit për secilën nga klasat e aktiveve.....	10
3.9. Pengesat ligjore, rregullative dhe operacionale për transferueshmërinë e likuiditetit ndërmjet njësive kryesore të likuiditetit .....	11
3.10. Pengesat ligjore dhe operacionale për përdorimin e kolateralit në kohë të shkurtër.....	11
3.11. E drejta e pezullimit ose përfundimit të kontratës që mund të ushtrojnë kunderpalët .....	12
4. Udhëzues për ushtrimin e skenarit të likuiditetit.....	12
4.1. Kohëzgjatja e krizës ndikon në dinamikat e likuiditetit.....	12
4.2. Skenarët çojnë bankën në një situatë pranë paaftësisë paguese .....	13
4.3. Skenarët mbështeten në supozimin e një përkeqësimi të ndjeshëm të likuiditetit .....	14
4.4. Përdorimi i masave të rimëkëmbjes .....	14
4.5. Skenarët marrin në konsideratë strategjinë e preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.....	15
4.6. Skenarët marrin në konsideratë kontekstin pas zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.....	15
4.7. Prezantimi i rezultateve të vlerësimit.....	16

## 1. Qëllimi dhe objektivat<sup>2</sup>

Bankat mund të përballen me situatën e mungesës së likuiditetit gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme si pasojë e hezitimit të pjesëmarrësve të tregut, bizneseve dhe individëve për të rifinancuar dhe ofruar financime për një bankë që kalon një situatë krize. Edhe pas ekzekutimit të suksesshëm të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, *stres-testet* e likuiditetit duhet të vijojnë për një periudhë të caktuar kohe, nisur nga asimetria e informacionit rreth përshtatshmërisë së modelit të biznesit për një bankë që i është nënshtruar ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Sikurse theksohet në Aneksin 2 të Rregullores nr.31, datë. 4.4.2018 “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, e ndryshuar, në përputhje me “Objektivin C”, të këtij aneksi, banka duhet të (i) zhvillojë metodologjitë për të vlerësuar nevojat për likuiditet dhe financim para dhe pas zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme (ii) të jetë e aftë të masë, raportojë dhe parashikojë pozicionin e likuiditetit dhe treguesit përkatës të tij gjatë procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme (iii) të jetë e aftë të identifikojë dhe mobilizojë aktivet (veçanërisht ato me cilësi të ulët dhe më pak likuide) që mund të përdoren si kolateral për të gjeneruar likuiditet në ndërhyrjen e jashtëzakonshme, duke paraprirë çdo pengesë ligjore, rregullative dhe operationale në mobilizimin e tyre në një situatë stresi.

Ky udhëzues fokusohet në dimensionin e parë (në vlerësimin e nevojave për likuiditet), duke synuar nxitjen e aftësisë së bankës për të garantuar zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe gatishmërisë për zbatimin e saj. Gjatë përmbushjes së këtyre objektivave, banka duhet të përdorë të gjitha kapacitetet e zhvilluara më herët për qëllime mbikëqyrëse (p.sh. planifikimin e rimëkëmbjes). Megjithatë, banka pritet të adresojë edhe disa aspekte specifike të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, siç trajtohen në këtë dokument.

## 2. Zbatimi dhe faza përgatitore

Në përputhje me qëllimin e përshkruar në Aneksin 2 të Rregullores nr.31, dt. 4.4.2018 “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, e ndryshuar (në vijim, rregullore nr.31/2018), ky udhëzues trajton hapat që duhet të ndërmerren nga secila bankë, që ka si strategji ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Bankës mund t’i kërkohet të ofrojë informacion dhe analiza specifike në përputhje me këtë udhëzues, në rastet kur kjo vlerësohet e rëndësishme për qëllime të ecurisë së planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe për qëllime të përmirësimit të aftësisë së saj për të zbatuar këtë të fundit, sipas ciklit përkatës. Përmbushja e objektivave të përcaktuara në Aneksin 2 të Rregullores nr.31/2018, i nënshtrohet një procesi gradual përgatitor, sipas afateve përkatëse të komunikuar nga Autoriteti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme.

Ky udhëzues zbatohet për objektivin e financimit dhe likuiditetit gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, i cili duhet të përmbushet deri në fund të vitit 2023. Udhëzuesi synon të plotësojë përmbajtjen e Aneksit të mësipërm të rregullores, duke ofruar udhëzime të qarta për plotësimin e kërkesave të këtij dokumenti. Ai është i strukturuar në katër seksione që mbulojnë në mënyrë të veçantë secilën nga fushat si më poshtë:

- a. Seksioni i parë fokusohet në identifikimin e njësive kryesore të likuiditetit (NjKL) dhe rrjedhën e likuiditetit gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
- b. Seksioni i dytë fokusohet në vlerësimin e faktorëve kryesorë që përcaktojnë pozicionin e likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme.
- c. Seksioni i tretë fokusohet tek metodologjitë e vlerësimit të pozicionit të likuiditetit gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
- d. Seksioni i katërt ofron udhëzime për zbatimin e analizave të skenarëve që do të zhvillohen gjatë vitit.

Ky udhëzues hartohet për të mbështetur zbatimin për herë të parë të politikës së likuiditetit nga bankat, gjatë ciklit vjetor të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe do të jetë subjekt i ndryshimeve dhe përditësimeve përgjatë kohës, sipas nevojës (p.sh. pas rishikimit të informacionit të raportuar nga bankat).

### **3. Udhëzuesi operacional**

#### **3.1. Identifikimi i njësive kryesore të likuiditetit (NjKL)**

1. Banka identifikon njësitë kryesore të likuiditetit (NjKL) në ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe shpjegon përse këto njësi janë të rëndësishme ose jo për këtë të fundit. Banka garanton që fokusi i analizës së njësive kryesore të likuiditetit të përfshijë:
  - a. të gjitha njësitë ligjore/subjektet e rëndësishme në kontekstin e Rregullores nr.72, dt. 6.12.2017 “Për planet e rimëkëmbjes së bankave”. Këto njësi janë: (i) njësitë që ofrojnë funksione kritike (ii) kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në totalin e aktiveve të ponderuara me rrezik ose të ekspozimit total apo të ardhurave të grupit;
  - b. të gjitha njësitë e tjera apo ndarjet organizative që mund të jenë të rëndësishme për qëllime të likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme.
  - c. vëmendje e veçantë i kushtohet :
    - i. degëve të rëndësishme, veçanërisht atyre jashtë vendit;
    - ii. entiteteve me qëllim të posaçëm (SPV) ose atyre emetuese (p.sh. emetuesit e obligacioneve të kolateralizuara) filialet e të cilave nuk ofrojnë funksione kritike ose nuk kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në të ardhura dhe aktive, por ofrojnë akses në tregje të një rëndësie të veçantë strategjike (p.sh. tregun e monedhave të huaja);
    - iii. shoqërive të sigurimit dhe ri-sigurimit;
    - iv. shoqërive të qirasë financiare dhe faktoringut;
    - v. shoqërive të administrimit të fondeve të pensionit;

- vi. shoqërive të administrimit të aktiveve;
  - vii. njësive të ndërmjetësimit;
  - viii. institucioneve të kujdestarisë dhe depozitarëve.
- d. Në parim, që një subjekt apo njësi të klasifikohet si njësi kryesore e likuiditetit dhe të përfshihet në të paktën një nga skenarët e mëposhtëm gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ai duhet të:
- i. ofrojë likuiditet tek njësitë e tjera të grupit me qëllim që këto të fundit të kryejnë veprimtarinë e tyre;
  - ii. varet nga likuiditeti i ofruar nga njësitë e tjera me qëllim që të kryejë aktivitetet e tij; ose
  - iii. kryejë funksione të administrimit të likuiditetit për një apo disa njësi të grupit bankar që i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
4. Për subjektet e grupit që vlerësohen si të rëndësishme për qëllime të hartimit të planeve të rimëkëmbjes, por nuk konsiderohen si njësi kryesore të likuiditetit, banka justifikon përse këto subjekte nuk ndikojnë në manaxhimin e likuiditetit dhe pozicionin e grupit gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe sesi do të manaxhohej likuiditeti i këtyre subjekteve në një situatë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
5. Bazuar në NjKL të identifikuar, banka kryen një analizë/ shpërndarje të likuiditetit dhe financimit të caktuar për grupin në një situatë ndërhyrjeje të jashtëzakonshme, duke trajtuar aspektet e mëposhtme:
- a. diferencat kryesore mes një situatë të vijimësisë së biznesit (*business as usual*) dhe financimit në ndërhyrje të jashtëzakonshme;
  - b. rolin e secilës njësi të likuiditetit (marrës apo ofrues i likuiditetit) dhe shkallën e pavarësisë në manaxhimin e tij, duke përfshirë aksesin në tregjet e financimit me shumice dhe Bankën Qendrore;
  - c. veprimtaritë kryesore të dhënies dhe marrjes së likuiditetit, duke bërë dallimin për afatin e maturimit (afatshkurtër dhe afatgjatë) dhe monedhave përkatëse për secilën njësi kryesore të likuiditetit;
  - d. ndryshimet në ndërlidhjet dhe ndërvarësitë (marrëveshjet e financimit brenda grupit) mes njësive kryesore të likuiditetit që ndodhin gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme (veçanërisht në drejtim të grupeve bankare ndërkufitare).

### Hapësirë informuese 1: “Gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme”

Shprehja “gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme” përdoret përgjatë këtij udhëzuesi për të theksuar rrethanat specifike që duhet të merren në konsideratë gjatë analizës së trajtuar në të. “Gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme” trajton nevojën për të marrë parasysh të gjitha fazat e mëposhtme, bashkë me dimensionet përkatëse, të cilat nuk janë as kufizuese dhe as shteruese:

1. Faza drejt ndërhyrjes së jashtëzakonshme (javë/muaj para ndërhyrjes së jashtëzakonshme):
  - a. Përkeqësim i ndjeshëm i situatës së bankës teksa rimëkëmbja nuk zbatohet;
  - b. Masat e rimëkëmbjes janë ezauruar dhe kanë rezultuar jo efektive;
  - c. Sjellja e tregjeve, ndërmjetësve dhe skontimet/çmimet e kundërpalëve në kushtet e pasigurisë, rreziqet me të cilat përballen ekspozimet e një banke në prag të paaftësisë paguese;
  - d. Materializimi i faktorëve që nxisin nevojën për likuiditet në ndërhyrje të jashtëzakonshme.
2. Dita/ fundjava e ndërhyrjes së jashtëzakonshme:
  - a. Banka deklarohet të jetë pranë paaftësisë paguese dhe zbatohet strategjia e preferuar e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
  - b. Në varësi të strategjisë së preferuar, ndikohet profili i kohëzgjatjes së kontratave (p.sh. ndërprerja e pagesave të kuponit për instrumentet e borxhit që i nënshtrohen zhvlerësimit/rikapitalizimit nga brenda) si dhe profili i likuiditetit në tërësi për bankën.
3. Faza e stabilizimit (javë/muaj pas ditës/fundjavës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme):
  - a. Nisur nga asimetria e informacionit rreth vazhdimësisë së biznesit për një bankë që i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtëzakonshme, situata e likuiditetit dhe e financimit të bankës mbetet e dobët dhe si pasojë e krizës, reduktohet aksesimi në financime të jashtme;
  - b. Faktorët kryesorë që nxisin nevojën për likuiditet vijnë të jenë prezentë edhe gjatë javës/muajit të parë pas ditës/fundjavës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

### **3.2. Identifikimi i faktorëve kryesorë që nxisin nevojën për likuiditet gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

6. Faktorët kryesorë që ndikojnë tek likuiditeti gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë faktorët që nxisin një përkeqësim të ndjeshëm të pozicionit të likuiditetit të bankës. Ky përkeqësim shfaqet në rritjen e flukseve dalëse, në rënien e flukseve hyrëse ose në zhvlerësim të kapacitetit kundërpeshues të bankës.
7. Banka liston të gjithë faktorët kryesorë të likuiditetit gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme në nivelin e grupit bankar dhe në nivelin e njësisive kryesore të likuiditetit, përgjatë periudhave të ndryshme. Banka angazhohet vazhdimisht me Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për të përcaktuar se cilat janë njësitë kryesore, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre dhe kompleksitetin e grupit.

8. Objektivi i këtij vlerësimi është vlerësimi cilësor i faktorëve nxitës të likuiditetit, ku banka përshkruan dinamikat e likuiditetit që shkaktohet në ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke plotësuar ushtrimin lidhur me vlerësimin e pozicionit të likuiditetit siç përshkruhet në seksionin e tretë dhe katërt të këtij udhëzuesi.
9. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, banka zbaton një qasje gjithëpërfshirëse, duke trajtuar të gjitha dinamikat që nxisin ndërhyrjen e jashtëzakonshme pa konsideruar një skenar specifik, por, duke identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në pozicionin e likuiditetit gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, bazuar tek natyra e biznesit të saj dhe struktura e financimit.
10. Banka identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në elementët e pozicionit të likuiditetit (flukset hyrëse, dalëse dhe kapaciteti kundërpeshues) gjatë fazave të ndryshme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme:
  - a. faza përgatitore (javët/muajin para fundjavës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme);
  - b. gjatë periudhës pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme (gjatë javës(ve) të fazës së stabilizimit, pra për të paktën gjashtë muaj pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme).
11. Banka e kryen këtë vlerësim, duke marrë në konsideratë periudha të ndryshme kohore para dhe pas fundjavës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme (p.sh. të përshtatura me ndryshimet e përshkruara në Tabelën 1, më poshtë, në baza javore gjatë fazës pranë ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe në baza mujore për periudhat e tjera).
12. Çdo faktor kryesor, nxitës i likuiditetit vlerësohet në raport me secilën periudhë kohore, duke i caktuar edhe një vlerësim përkatës sasior (p.sh. i lartë/i mesëm/i ulët). Ky vlerësim individual përfaqëson rëndësinë relative të secilit faktor në likuiditetin e bankës për secilën periudhë kohore, duke marrë në konsideratë edhe peshën/madhësinë relative dhe rëndësinë e probabilitetin e ngjarjes. Rezultati finlizohet në një vlerësim të detajuar, i cili përmban një pasqyrë të përgjithshme, si ajo e ilustruar në Tabelën 1.
13. Në vlerësimin e saj, banka përfshin, ndër të tjera një:
  - a. shpjegim të metodologjisë së përdorur për vlerësimin sasior;
  - b. përshkrim të zhvillimit (madhësinë) të secilit faktor të likuiditetit përgjatë periudhës kohore të konsideruar;
  - c. analizë të faktorëve të pozicionit të likuiditetit për secilën nga monedhat përkatëse.
14. Me qëllim që të identifikohen faktorët kryesorë të likuiditetit gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, banka mbështetet në identifikimin e rrezikut që ka konkluduar gjatë vlerësimit të ILAAP dhe në Planin e Rimëkëmbjes. Megjithatë, banka konsideron sesi rreziqet e identifikuara në një situatë të “vijmësisë së biznesit” (*business as usual*) ndryshojnë në një skenar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke reflektuar efektet e paaftësisë paguese dhe të hapave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

## Hapësirë informuese 2: Lista joshteruese e faktorëve kryesorë të likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme

- Tërheqjet e depozitave: të ndara sipas llojit për të treguar shkallë të ndryshme të rreziqeve të likuiditetit (depozita me dhe pa afat, të siguruara, llogari *escrow* ose jo, etj);
- Tërheqjet e angazhimeve të kredisë: likuiditeti i kredive të biznesit dhe linjave të kredisë, *overdraft*-et, kartat e kreditit;
- Kërkesat e likuiditetit dhe të kolateralit për Infrastrukturën e Tregjeve Financiare (ITF);
- Mungesa e aksesit në financimin me shumicë (repo, financim i pasiguar, letra tregtare) dhe nëse financimet janë me maturim të shkurtër (nevoja për rinovim është më e shpeshtë);
- Përkeqësimi i vlerësimit të kredisë: ndikimi i përkeqësimit të vlerësimit deri në shkallën pranë “*non-investment*”;
- Tërheqjet e lidhura me derivativët: maturimi i *Swap*-eve në monedhë të huaj (duke përfshirë nevojat ditore për likuiditet), tërheqjet e lidhura me kolaterale, etj;
- Detyrimet kontraktuale që nxiten nga ndërhyrja e jashtëzakonshme, si klauzolat përkatëse dhe ripagesat e përshpejtuara;
- Kostot e lidhura me ndërhyrjen e jashtëzakonshme, si p.sh. kostot e ristrukturimit;
- Reduktimi i flukseve hyrëse për shkak të ndërhyrjes së jashtëzakonshme: paaftësia paguese e kreditorëve dhe investitorëve si pasojë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme (të cilët ndalojnë pagesat në anën e aktiveve), ulja e çmimit të aksioneve (më pak incentivë për bankën që të financohet nëpërmjet kapitalit të paguar);
- Ndërprerja e financimit brenda grupit
- Përkeqësimi i kapacitetit kundërpeshues në tërësi.

Tabela 1. Faktorët kryesorë të pozicionit të likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme (shembuj)

Faktorët ndikojnë likuiditet	që në	Një javë para NJZ	Fundjava NJZ	Java 1	Java 2	Java 3	Java 4	2 muaj	.	6 muaj
Tërheqjet e depozitave (biznesi)	e	L		M	M	M	M	M	.	U
Tërheqjet e depozitave (individët)	e	L		L	L	M	M	U	.	U
Tërheqjet e angazhimeve të huave të biznesit	e	M		M	M	U	U	U	.	U
Kërkesat e ITF	e	L		L	L	M	U	U	.	U
...										
Mungesa e financimit me shumicë	e	L		L	L	M	M	M	.	M



15. Banka zhvillon metodologji për të vlerësuar paraprakisht likuiditetin dhe financimet e nevojshme për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke u mbështetur në supozime të caktuara. Gjatë hartimit të metodologjive, mund të përdoren kapacitetet ekzistuese (p.sh. *stres-testet* e brendshme, planifikimi i rimëkëmbjes, kuadri i rrezikut të likuiditetit të zhvilluar për qëllime të mbikëqyrjes, etj.). Megjithatë, këto metodologji duhet të jenë specifike për ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Objektivat dhe karakteristikat kryesore të këtyre metodologjive përshkruhen në Aneksin 2, të Rregullores nr.31/2018. Në këtë drejtim, ky udhëzues synon të ofrojë qartësi të shtuar për bankat lidhur me aspektet kryesore që adresojnë këto metodologji (Parimi C.1).
16. Në linjë me objektivat e këtij vlerësimi, banka evidenton aftësinë për të zhvilluar këto analiza, duke prekur të gjitha dimensionet e rëndësishme dhe duke identifikuar dinamikat dhe faktorët që kontribuojnë më shumë në vlerësimin e pozicionit të likuiditetit. Në këtë kontekst duhet të mbahet parasysh që ky nuk është një ushtrim i kalimit/ dështimit të *stress-testit* të likuiditetit dhe se evidentimi i një pozicioni negativ të likuiditetit është rezultat i pritshëm.
17. Për sa më sipër, banka zhvillon një kuadër metodologjik për vlerësimin e pozicionit të likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke marrë në konsideratë, sipas rëndësisë, listën e mëposhtme:

### 3.3. Sjellja e kundërpalës gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme

18. Banka kalibron metodologjitë e saj, duke trajtuar faktorë të sjelljes që ndikojnë në zërat jokontraktuale si:
  - a. zërat me maturim të hapur (tërheqjet e depozitave, REPO-t);
  - b. rinovimin e financimeve ekzistuese dhe përfitimin e atyre të reja;
  - c. tërheqjen e angazhimeve për linjat e kredisë.Për aspektet e mësipërme, banka argumenton lidhur me kalibrimin e parametrave përkatës (normën e flukseve dalëse, supozimet e rinovimit të financimit, *haircut*-et e zbatuara, etj.).

### 3.4. Detyrimet financiare që lidhen me aksesin në Infrastrukturën e Tregjeve Financiare kritike

19. Banka shfrytëzon punën e kryer gjatë hartimit të planeve të kontigjencës për të parashikuar nevojat e likuiditetit të lidhura me ITF në ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Ajo kryen një vlerësim të agreguar të nevojave për likuiditet për ITF dhe vlerëson likuiditetin maksimal që mund të kërkohet për të garantuar aksesin në ITF, ndërmjetësit përkatës dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve.
20. Gjatë hartimit të planeve të kontigjencës për ITF, banka specifikon në çfarë forme do të materializohen nevojat e shtuara për likuiditet (p.sh. kërkesë në rritje për likuiditet, marzhe

të rritura, kontribute shtesë në fond (për qëllime të mbulimit të rrezikut të paaftësisë paguese), financim paraprak, kolateral me cilësi më të mirë, etj.) si dhe argumenton supozimet dhe modelet ku mbështetet llogaritja e nevojave për likuiditet në kushte stresi. Banka i shpërndan këto kërkesa sipas njësive kryesore të likuiditetit.

21. Vlerësimi i bankës duhet të jetë konsistent me raportimin në formularin “Anëtarësimi në Infrastrukturën e Tregjeve Financiare”, ku përfshihen zërat, si: linjat e kredisë, niveli maksimal i likuiditetit ditor (*intraday*), kërkesat e kolateralit, nevoja shtesë për likuiditet dhe kërkesat për kolateral në një situatë stresi.

### 3.5. Nevojat ditore (intraday) për likuiditet

22. Metodologjia e bankës përfshin një vlerësim të nevojave ditore për likuiditet gjatë fazave të ndryshme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në nivel të agreguar dhe në nivelin e monedhave kryesore. Në linjë me standardet përkatëse, këta matës të likuiditetit konsistojnë në treguesit e përdorur nga banka gjatë ecurisë normale të biznesit si:
  - a. Përdorimi maksimal ditor i likuiditetit;
  - b. Likuiditeti ditor në dispozicion në fillim të ditës;
  - c. Vlera totale e pagesave të kryera dhe të marra gjatë ditës.

### 3.6. Detyrimet financiare të lidhura me vazhdimësinë operacionale

23. Banka garanton që vlerësimi i saj merr në konsideratë mjetet financiare të nevojshme për të vijuar ofrimin e shërbimeve që mbështesin funksionet kritike dhe veprimtaritë kryesore. Banka konsideron mes të tjerash, pagesat tek ofruesit kryesorë të shërbimeve, qendrat e shërbimeve të përbashkëta, pagesën e pagave dhe detyrimeve, liçencat dhe shpenzimet e tjera që duhen për të mbajtur sistemet e TI në aktivitet të plotë.

### 3.7. Ndikimi i veprimeve të agjencive të vlerësimit (*rating agencies*)

24. Banka merr në konsideratë ndikimin e përkeqësimit të vlerësimit në pozicionin e likuiditetit (p.sh. kërkesat shtesë nga kundërpalët, ITF, etj.) dhe aftësinë për të përfituar financime nëpërmjet transaksioneve të zakonshme në treg. Në praktikë, agjencitë e jashtme të vlerësimit të kredisë (ECAI) mund të caktojnë vlerësime të ndryshme të përkeqësuar, megjithatë, supozimi bazë është që në prag të zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, vlerësimi do të jetë në nivelin e “*non-investment grade*”.

### 3.8. Vlera e likuiditetit për secilën nga klasat e aktiveve

25. Metodologjia e bankës përfshin vlerësimin e aktiveve që mund të përdoren për të gjeneruar likuiditet në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Banka vlerëson likuiditetin që mund të

gjenerohet nga aktivet e tregtueshme e të patregtueshme nëpërmjet shitjes së tyre, marrëveshjeve të riblerjes apo vendosjes së tyre si kolateral për të përfituar financime nga Banka Qendrore, si pjesë e operacioneve të rregullta monetare.

26. Banka zhvillon procese të automatizuara për të llogaritur dhe vlerësuar nevojën për likuiditet pas aplikimit të niveleve të ndryshme të faktorëve zbritës (*haircut-eve*) për klasa të ndryshme aktivesh. Kuadri i përdorur për të llogaritur vlerën e likuiditetit duhet të jetë fleksibël që të lehtësojë ndryshimin e parametrave të faktorëve të ndryshëm zbritës menjëherë, pas një njoftimi të shkurtër. Për aktivet që plotësojnë kriteret e financimit nga Banka Qendrore, banka mbështetet në faktorët e publikuar nga kjo e fundit. Për të gjitha aktivet e tjera, banka mbështetet në përvojën e grumbulluar nga krizat e mëparshme dhe *stres-testet* e likuiditetit, duke përdorur gjykimin e ekspertit për të përcaktuar faktorët përkatës të zbritjes. Këta të fundit duhet të jenë konservative që të marrin parasysh kushtet e veçanta të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe hezitimin e investitorëve për t'u angazhuar me bankën në këto rrethana. Banka i kushton vëmendje të veçantë aftësisë për të vlerësuar likuiditetin që mund të gjenerohet nga aktivet e patregtueshme, duke marrë parasysh karakteristikat e këtyre të fundit (p.sh. cilësia e kredisë, monedha, lloji i klientit, etj)

### **3.9. Pengesat ligjore, rregullative dhe operacionale për transferueshmërinë e likuiditetit ndërmjet njësive kryesore të likuiditetit**

27. Gjatë zhvillimit të kuadrit të vlerësimit të pozicionit të likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme, banka konsideron pengesat potenciale për transferimin e likuiditetit ndërmjet NjKL, në veçanti nëse vendndodhja e tyre është në shtete të ndryshme, për shkak të kërkesave rregullative (p.sh. kërkesat prudenciale në nivel individual, ekspozimet e mëdha brenda grupit), ligjore (ligji i shoqërive tregtare, rezerva e detyrueshme, kufizimet për transferimin e likuiditetit lokal jashtë vendit) ose pengesave operacionale (p.sh. aksesit në ITF, nevojat lokale për likuiditet për të garantuar vazhdimësinë e funksioneve kritike).
28. Banka, gjatë hartimit të metodologjive përkatëse, konsideron aspektet e mësipërme, duke zbatuar një qasje konservative, ku pasiguria (p.sh. duke marrë parasysh veprimet e ndërmarra nga autoritetet rregullatore lokale) pengon vlerësimin e saktë të çdo burimi për likuiditet.

### **3.10. Pengesat ligjore dhe operacionale për përdorimin e kolateralit në kohë të shkurtër**

29. Gjatë zhvillimit të kuadrit për vlerësimin e pozicionit të likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme, banka merr në konsideratë të gjitha pengesat ligjore dhe operacionale për bllokimin e kolateralit (p.sh. miratimi i huamarrësit, njohja kontraktuale). Banka merr në konsideratë kohën e nevojshme për mobilizimin e klasave të ndryshme të aktiveve dhe e reflekton atë në vlerësimin e pozicionit të likuiditetit. Banka zbaton një qasje konservative, në të gjitha rastet kur pasiguria pengon vlerësimin e saktë të disponueshmërisë së kolateralit.

### **3.11. E drejta e pezullimit ose përfundimit të kontratës që mund të ushtrojnë kundërpalët**

30. Gjatë zhvillimit të kuadrit të vlerësimit të pozicionit të likuiditetit në ndërhyrjen e jashtëzakonshme, banka merr në konsideratë nevojat potenciale për likuiditet që rezultojnë nga pezullimi apo përfundimi i kontratave gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme (p.sh. përfundimi para afatit i aspekteve kontraktuale të netimit që lidhen me derivativët). Në veçanti, banka vlerëson rrezikun e nevojës shtesë për likuiditet që lind në ndërhyrje të jashtëzakonshme pas përfundimit të kontratave që lidhen me derivativët e llojit “mbi banak” (OTCD) apo kontratat për Transaksionet e Financimit të Letrave me Vlerë (SFT), sipas ligjeve të një vendi të tretë dhe në mungesë të njohjes kontraktuale të kompetencës së autoriteteve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, për të pezulluar përfundimin e këtyre kontratave.

## **4. Udhëzues për ushtrimin e skenarit të likuiditetit**

31. Gjatë vitit, banka duhet të zhvillojë një metodologji për të vlerësuar pozicionin e likuiditetit në ndërhyrje të jashtëzakonshme ku të zbatohet të paktën dy skenarë: një skenar të ngadaltë dhe një të shpejtë, të nxitur nga një ngjarje idiosinkratike që përfshin paaftësi paguese dhe mungesë likuiditeti njëkohësisht.

32. Banka përdor gjykimin e ekspertit, përvojën nga kriza të mëparshme dhe literaturën përkatëse që të kalibrojnë supozimet specifike për secilin skenar. Referencat përkatëse lidhur me kufijtë (*benchmark-et*), normat e tërheqjeve apo faktorët zbritës (*haircut-et*) që do të zbatohen, mund të përdoren nga *stres-testet* e likuiditetit të zhvilluara për qëllime të stabilitetit financiar. Megjithatë, banka duhet të kenë parasysh që kjo metodologji, ndonëse reflekton një situatë stresi të përkeqësuar, nuk pasqyron situatën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe për rrjedhojë nevojitet të përshtatet në këtë kontekst.

33. Nga ana tjetër, ndonëse analiza e skenarëve e zhvilluar për qëllime të planifikimit të rimëkëmbjes mund të përdoret si pikënisje, banka duhet të hartojë dhe zbatojë skenarë specifikë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Skenarët përshtaten sipas modelit të biznesit të secilës bankë dhe respektojnë parimet e përshkruara në paragrafët e mëposhtëm:

### **4.1. Kohëzgjatja e krizës ndikon në dinamikat e likuiditetit**

34. Në një skenar të ngadaltë, banka supozon që do t'i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtëzakonshme jo më herët se 12 muaj pas fillimit të krizës. Në një skenar të përshpejtuar të krizës, banka i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtëzakonshme në një periudhë jo më shumë se 3 muaj nga fillimi i krizës.

35. Kohëzgjatja e krizës ndikon në strukturën e grupit bankar para ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në pozicionin e likuiditetit dhe në bilancin e bankës në momentin e zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe veçanërisht në mënyrën sesi banka zbaton masat e rimëkëmbjes:
- një skenar i përshpejtuar nënkupton që banka ka në dispozicion një kohë të kufizuar për të zbatuar planin e saj të rimëkëmbjes, nëse merret parasysh ruajtja e modelit të saj të biznesit dhe struktura organizative. Gjatë kësaj periudhe konsiderohen apo zbatohen vetëm masat e rimëkëmbjes që kërkojnë më pak se tre muaj kohë për t'u zbatuar;
  - në një skenar të ngadaltë, banka ka kohë më të gjatë për të implementuar ndryshime strukturore, si iniciimi i masave të rimëkëmbjes, shitja e një pjese të biznesit apo riorganizimi i saj.
36. Analiza simulon pozicionin e likuiditetit në të gjitha monedhat kryesore përgjatë fazave të ndryshme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, para ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në momentin e paaftësisë paguese dhe për një periudhë jo më të shkurtër se 6 muaj pas zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, për të gjitha monedhat e rëndësishme.
37. Kohëzgjatja e skenarëve ndikon në periudhën që duhet të konsiderohet për përgatitjen e ndërhyrjes së jashtëzakonshme:
- në skenarin e përshpejtuar, kjo periudhë konsiston në muajin e fundit para shpalljes së paaftësisë paguese;
  - në skenarin e ngadaltë, kjo periudhë duhet të përfshijë 3 muajt para shpalljes së paaftësisë paguese.

#### **4.2. Skenarët çojnë bankën në një situatë pranë paaftësisë paguese**

38. Faktorët që konsiderohen si nxitës të krizës lihen në vendimmarrjen e bankës. Banka supozon që faktorët e stresit të marrë në konsideratë gjatë ushtrimeve të mbikëqyrjes (p.sh. skenari idiosinkratik i krizës i trajtuar në planin e rimëkëmbjes) marrin vlera ekstreme, duke bërë që masat e rimëkëmbjes të rezultojnë të pasuksesshme dhe banka të hyjë në fazën pranë paaftësisë paguese.
39. Banka cakton një skenar të besueshëm stresi të shkaktuar kryesisht nga mungesa e likuiditetit, i cili e çon bankën pranë paaftësisë paguese. Për këtë qëllim, banka kryen vetë një vlerësim që mund të çojë në paaftësi paguese, bazuar tek gjykimi i ekspertit dhe kriteret e përcaktuara në nenin 21, pika 2, të Ligjit 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”.

### 4.3. Skenarët mbështeten në supozimin e një përkeqësimi të ndjeshëm të likuiditetit

40. Ndërsa banka ka përgjegjësinë që të modelojë trajektoren e saktë të deklarimit të paaftësisë së saj paguese, për të thjeshtuar procesin, ajo supozon që në deklarimin e paaftësisë paguese, ndikon një përkeqësim i ndjeshëm i treguesve kryesorë të likuiditetit.
41. Në momentin e paaftësisë paguese, banka duhet të ketë ezauruar një pjesë të rëndësishme të masave që ndërmerren për të gjeneruar likuiditet dhe kapacitetin kundërpeshues. Masat e rimëkëmbjes të ndërmarra në nivelin e kapacitetit kundërpeshues në pikën e paaftësisë paguese reflektojnë karakteristikat e skenarit: në përgjithësi, një skenar përkeqësimi i ngadaltë mund t'ua lejojë bankën të marrë disa masa më shumë rimëkëmbjeje, sesa një krizë që sjell përkeqësim të shpejtë.
42. Banka, aty ku e gjykon të rëndësishme për modelin e biznesit apo të financimit të saj, konsideron:
  - a. tërheqjet e papritura të depozitave, veçanërisht gjatë fazës pranë ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe në ditët që pasojnë fundjavën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
  - b. pamundësinë e financimit me shumicë dhe pamundësinë për të gjeneruar borxh të ri në periudhën para dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
  - c. shtimin e kërkesave për likuiditet nga ITF në periudhën para ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
  - d. reduktimin e ndjeshëm të aktiveve likuide me cilësi të lartë.

### 4.4. Përdorimi i masave të rimëkëmbjes

43. Në përgjithësi, skenarët marrin parasysh ushtrimin e masave të rimëkëmbjes që përputhen me skenarët e krizës dhe me një situatë të theksuar stresi (p.sh. duke mos konsideruar emetimin e instrumenteve financiarë).
44. Përdorimi i masave të rimëkëmbjes duhet të jetë realist dhe të marrë në konsideratë horizontin kohor të secilës prej masave. Në parim, Plani i Rimëkëmbjes përfshin informacion për kohëzgjatjen dhe shtrirjen në kohë të secilës nga masat. Asnjë nga masat e trajtuara në këtë plan nuk do të përdorej në ditën menjëherë para dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Gjithashtu, banka duhet të konsiderojë masa të tjera shtesë, që nuk janë përfshirë në planin e rimëkëmbjes, të cilat janë specifike për ndërhyrjen e jashtëzakonshme (p.sh. ndërprerja e veprimtarive të caktuara).
45. Banka dhe Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme diskutojnë rreth masave të rimëkëmbjes që supozohet se do të ushtrohen nga banka gjatë simulimit dhe në çfarë shkalle, duke marrë në konsideratë jo vetëm afatin kohor të zbatimit të tyre, por edhe probabilitetin e përmbushjes së suksesshme të tyre në një situatë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Për

këtë qëllim, është e nevojshme të ndërtohet një plan kohor i përafërt zbatimi që trajton ndërvarësitë e mundshme.

#### **4.5. Skenarët marrin në konsideratë strategjinë e preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

46. Banka vlerëson nevojën për likuiditet për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke trajtuar edhe ndikimin e kësaj strategjie në pozicionin e likuiditetit në nivel grupi dhe subjektesh kryesore.
47. Banka vlerëson ndikimin e strategjisë së preferuar dhe të instrumentit përkatës të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në flukset e likuiditetit, aty ku është e përshtatshme (p.sh. në rast të ndalimit të pagesës së kuponave të ardhshëm/apo të pagesës së interesit për detyrimet e rikapitalizuara), duke trajtuar secilin skenar dhe reagimin e kundërpalëve përkatëse (ITF, ofruesit e financimit, depozituesit, etj.).
48. Në rastin e bankave, për të cilat strategjia e preferuar është ajo e transferimit të aktiveve, zbatimi i suksesshëm nënkupton ndarjen e plotë ose të pjesshme të aktiveve dhe shitjen e biznesit, duke zhvlerësuar pjesën e mbetur të tij. Në këtë rast, fokusi kryesor është ngritja e kapaciteteve për të vlerësuar nevojën për likuiditet dhe për të garantuar transferimin e suksesshëm të aktiveve/ aksioneve të bankës tek blerësi. Në periudhën pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, pas ekzekutimit të suksesshëm të shitjes së biznesit, njësia mund të mos ekzistojë më, dhe/ose mund të bëhet pjesë e një grupi tjetër dhe për rrjedhojë parashikimi i flukseve hyrëse do të varet nga blerësi. Ky proces ndikon në analizën e faktorëve kryesorë të rrezikut të likuiditetit dhe në parashikimet e këtij të fundit pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
49. Për bankat, strategjia e preferuar e të cilave është ajo e rikapitalizimit nga brenda, banka vlerëson më në detaje pozicionin e saj të likuiditetit në fazën pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme (sesa në rastin e strategjisë së transferimit dhe shitjes së aktiveve). Gjithashtu, në këtë rast, banka supozon se rreziku i likuiditetit mund të jetë më i lartë pas zbatimit të rikapitalizimit nga brenda, krahasuar me strategjinë e shitjes së biznesit, ku blerësi pritet të ofrojë mbështetje likuiditeti pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme

#### **4.6. Skenarët marrin në konsideratë kontekstin pas zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme**

50. Metodologjitë e bankës duhet të mundësojnë parashikimin e pozicionit të likuiditetit për 6 muajt pas fundjavës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Për rrjedhojë, banka përshkruan sjelljet e pritshme të kundërpalëve pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, bazuar në gjykimin e ekspertit dhe përvojën e sektorëve bankarë përgjatë krizave financiare të mëparshme. Për këtë qëllim, banka analizon sjelljet e kundërpalëve në të shkuarën dhe i përshtat ato me këtë

skenar. Gjithashtu, banka argumenton sjelljet e kundërpalëve pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme (nivelin e flukseve dalëse, faktorët përkatës zbritës dhe kushtet që lidhen me financimin e garantuar, etj.).

51. Gjatë këtij procesi banka merr parasysh supozimet e mëposhtme:

- a. Pas zbatimit të strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme (gjatë fazës së stabilizimit) banka ndërmerr disa iniciativa për të garantuar vazhdimësinë afatgjatë të saj, duke ruajtur funksionet kritike. Ky element duhet të jetë pjesë e Planit të Riorganizimit të Biznesit të bankës.
- b. Skenari merr në konsideratë veprimet që mund të zbatohen për të përmirësuar situatën e përgjithshme të likuiditetit (p.sh. masat e rimëkëmbjes që do të mbeten të vlefshme). Banka, gjithashtu merr në konsideratë masat që nuk janë trajtuar si të rëndësishme për rimëkëmbjen, por mund të jenë të tilla për ndërhyrjen e jashtëzakonshme (p.sh. ndërprerja e disa aktiviteteve ose mbyllja e një njësie të caktuar).
- c. Pavarësisht zbatimit të suksesshëm të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, nisur nga asimetria e informacionit që lidhet me qëndrueshmërinë e modelit të biznesit dhe/ose cilësinë e portofolit të aktiveve, banka qëndron në një situatë stresi edhe për disa kohë pas zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme (p.sh. aksesit në tregjet e instrumenteve të borxhit të pasiguruar me kolateral pritet të vijojë të jetë i kufizuar).
- d. Të gjitha instrumentet mbi të cilat është zbatuar rikapitalizimi (i pjesshëm) supozohet që pësojnë një përkeqësim në vlerësim në gradën “paaftësi paguese” dhe vlerësimi i emetuesit do të bjerë në gradën “nën-investim (*subinvestment*)” menjëherë pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Përmirësimi i vlerësimit përgjatë kohës rishikohet në varësi të pozicionit të likuiditetit, duke marrë në konsideratë thyerjen e treguesve të likuiditetit (LCR) pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

#### 4.7. Prezantimi i rezultateve të vlerësimit

52. Banka paraqet një shënim analitik për të prezantuar rezultatet e simulimeve të zhvilluara për të dy skenarët. Në këtë fazë, udhëzuesi nuk mundëson ndonjë format të gatshëm që banka mund të zgjedhë. Megjithatë, banka përshtat një prezantim të rezultateve të simulimit të pozicionit të likuiditetit, i cili paraqet elementët kryesorë sasiorë të tij.

53. Banka inkurajohet të përdorë si pikënisje formularët e gatshëm të likuiditetit të ndara sipas maturimeve përkatëse, si bazë orientimi për shkallën e detajimit të zërave dhe ndarjen në afate maturimi (duke detajuar burimet e flukseve dalëse, hyrëse dhe kapacitetin kundërpeshues).

54. Për qëllime të raportimit, shportat e ndryshme të maturimit duhet të jenë në linjë me ato të përdorura për vlerësimin e faktorëve kryesorë të likuiditetit. Për secilën shportë maturimi banka mundëson detaje lidhur me:



- a. flukset dalëse sipas llojit: detyrime që lindin nga instrumentet e emetuara, nga huadhënia me kolateral dhe veprimet e tregjeve të kapitalit, depozitat e mbuluara ose jo sipas llojit të klientit, angazhimet, derivativët në monedhë të huaj, mes të tjerash, duke përfshirë ato kontraktuale dhe me maturim të hapur;
- b. flukset hyrëse sipas llojit: flukse hyrëse nga huadhënia me kolateral dhe veprimet e tregjeve të kapitalit, huatë dhe paradhëniet sipas klientit, derivativet në monedhë të huaj, mes të tjerash, duke përfshirë ato kontraktuale dhe me maturim të hapur;
- c. kapacitetin kundërpeshues sipas llojit - *cash*, rezervat në Bankën Qendrore, aktive të nivelit 1, 2 etj.

55. Rezultati i simulimeve<sup>3</sup> përfshin për secilin skenar:

- a. ecurinë përgjatë të gjitha fazave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për pozicionin e likuiditetit dhe përbërësit e tij kryesorë (flukset hyrëse, dalëse dhe kapacitetin kundërpeshues) sipas maturimeve përkatëse;
- b. bilancin e përshtatur, sipas secilit skenar për të treja fazat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- c. ecurinë e treguesve kryesorë të likuiditetit (p.sh. LCR) dhe likuiditetin e nevojshëm për të risjellë treguesit në normë;
- d. një analizë sesi NjKL kontribuojnë në pozicionin neto të tij;
- e. një trajtim të ecurisë së nevojave për likuiditet në monedha të ndryshme.

---

<sup>3</sup> Periudha e referencës është fundi i vitit paraardhës